




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me datë: 15.06.2022, ndërmjet:

1. Komunës së Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës – Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;
2. “Ansambli Muzikor i Komunës së Gjakovës”, të cilën e përfaqëson Ideal Meka, në tekstin vijues Ansambli.

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim angazhimin e përbashkët në realizimin e projektit për koncertet e verës dhe për koncertin e dimrit për vitin 2022.

**Neni 2
Obligimet e Komunës**

- 2.1 Komuna e Gjakovës do të siguroj mjetet financiare në vlerë prej 15,000.00 euro për realizimin e plan projektit nga Ansambli Muzikor i Komunës – Orkestra Simfonike për koncertet e verës dhe dimrit për vitin 2022.
- 2.2 Mjetet që do të ndahen për organizimin e koncertit do të ekzekutohen pas pranimi të faturave e arsyeshmërive të shpenzimeve të cilat do të jenë të argumentuara nga “Ansambli”.
- 2.3 Mjetet në vlerë prej 15,000.00 euro do të ndahen nga kategoria mallra dhe shërbime e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.



Neni 3
Obligimet e “Ansambli-it”

3.1 Obligohet të sjellë faturat, origjinale, arsyeshmëritë e shpenzimeve përmes së cilave do të pasqyrohen shpenzimet e bëra, lidhur me aktivitetin e saj.

3.2 Të gjitha faturat duhet të dorëzohen në organet e administratës komunale së bashku me llogarinë bankare.

Neni 4
Realizimi i koncertit festiv

Realizimi i plan projektit për koncertet për vitin 2022 nga “Ansambli” fillon me koncertin veror dhe përfundon me koncertin festiv të fundvitit që do të realizohen në Komunën e Gjakovës.

Neni 5

Ky memorandum i bashkëpunimit është i përpiluar në 4 (katër) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilave nga dy ekzemplarë u dorëzohen palëve kontraktuese.


Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë në përpikmëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

P A L Ë T


Ardian Gjini
për
Kryetari i Komunës së Gjakovës




Ideal Meka
Ansambli Muzikor i Komunës së Gjakovës